

**V E N D I M**  
**Nr.623, datë 12.11.2001**

**PËR FINANCIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR DEPUTET,  
NË ZONËN ZGJEDHORE NR.98**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 7, të ligjit nr.8718, datë 19.12.2000, “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2001”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, të përdorë fondin prej 3 200 000 (tre milionë e dyqind mijë) lekësh, për financimin e zgjedhjeve të pjesshme për deputet, në zonën zgjedhore nr.98, që zhvillohen më datë 18 nëntor 2001.

2. Ky fond të përballohet nga zëri “fondi rezervë” i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i miratuar për financimin e fushatës zgjedhore, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr.301, datë 12.5.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2001, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e fushatës zgjedhore për në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me vendimet nr.352, datë 23.5.2001, dhe nr. 405, datë 11.6.2001, të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**